



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 3 DATE 19.01.2018

PER

**MIRATIMIN E BURSAVE TE SHTETIT PER STUDENTET NE
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PER VITIN AKADEMIK 2017-2018.**

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore",te V.K.M-se Nr.903,date 21.12.2016"Per percaktimin e kriterëve per perfitimin e bursave nga fondi i mbeshtetjes studentore per studentet e shkëlqyer,studentet qe studiojne ne programe studimi ne fushat prioritare dhe studentet ne nevoje",te Urdherit nr.658 date 27.12.2017"Per miratimin e numrit te bursave financiare per studentet qe ndjekin studimet ne IAL publike,te regjistruar ne vitin e pare akademik ne programet e ciklit te pare te studimeve,ne programet e studimeve me karakter profesional dhe ne programet e integruara te studimeve te ciklit te dyte ne Institucionet e Arsimit te Larte Publik,per vitin akademik 2017-2018" dhe shkreses nr.13231/1 date 27.12.2017 te Ministrise se Arsimit,Sportit dhe Rinise,Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

❖ **Miratimin e Bursave per studentet (vitet e para),per vitin akademik 2017-2018,si me poshte:**

1. **Anjeza Kujtim Vidhishta** – Burse e Plote,studente ne Universitetin "Ismail Qemali" Vlore,Fakulteti i Shkencave Humane,dega Gjuhe Shqipe dhe Letersi.
2. **Emanuelio Afrim Yzbashi** – Burse e Plote,student ne Universiteti Politeknik i Tiranes,Fakulteti i Inxhinierise Mekanike,dega Mekanike.
3. **Artjola Izet Xeba** – Burse e plote,studente ne Universiteti "Ismail Qemali" Vlore,Fakulteti i Ekonomise,dega Bachelor ne Finance.
4. **Eristjan Jonus Paftalaku** – Burse e Plote,student ne Universiteti "Ismail Qemali" Vlore,Fakulteti i Ekonomise,dega Bachelor ne Administrim Biznesi.

5. **Savjola Dritan Ferro** – Burse e Plote, studente ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Shendetit Publik, ne programin Infermieri Mami.
6. **Eraldo Ilir Doksani** – Burse e Plote, student ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Ekonomise, dega Bachelor ne Administrim Biznesi.
7. **Dorisa Ilir Doksani** – Burse e Plote, studente ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Ekonomise, dega Bachelor ne Finance.
8. **Bajame Pellumb Buzi** – Burse e Plote, studente ne Universiteti Bujqesor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit, ne programin e studimit Ekonomi dhe Agrobiznes, profili Ekonomiks i aplikuar.
9. **Anxhela Perparim Agaçi** – Burse e Plote, studente ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Drejtesise, programi i studimit “Bachelor ne Drejtesi”.
10. **Xhoana Kristo Sakaj** – Burse e Plote, studente ne Universiteti i Mjekesise Tirane, Fakulteti i Mjekesise, ne programin e studimit MSC ne Mjekesi e Pergjithshme.
11. **Marie Gezim Xhoka** – Burse e Plote, studente ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Shkencave Humane, ne programin Histori-Gjeografi.
12. **Mateo Fatmir Hajdini** – Burse e Plote, student ne Universiteti “Aleksander Moisiu” Durres, Fakulteti i Studimeve Profesionale, ne degen “Informatike Praktike”.
13. **Eni Jorgo Kola** – Burse e Plote, studente ne Universiteti i Mjekesise Tirane, Fakulteti i Mjekesise Dentare, ne programin e studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji”.
14. **Sara Jorgo Kola** – Burse e Plote, studente ne Universiteti i Mjekesise Tirane, Fakulteti i Mjekesise, ne programin e studimit MSC ne Farmaci.
15. **Redona Arben Dyle** – Burse e Plote, studente ne Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Fakulteti i Shendetit Publik, ne programin Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, Tel/Fax : 0382 22117

VENDIM

NR 4 .DATE 19. 01 .2018

"PER

MBLEDHJEN E TAKSAVE DHE TARIFAVE FAMILJARE NEPERMJET NJE AGJENTI"

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 54, germa f; ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar neni 5; Ligjit Nr.9632 dt.30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" neni 35 , pika 2, germa b; Udhezimit nr 24 date 02.09.2018 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise"; Vendimin e Keshillit te Bashkise Roskovec nr 73 dt.24.11.2018 "Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2018", Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

1. Miratimin per mbledhjen e taksave dhe tarifave familjare nepermjet Agjentit Tatimor, Ujesjelles-Kanalizime Sh.A. Roskovec.
2. Miratimin e rregullave baze per mbledhjen e ketyre taksave dhe tarifave vendore si me poshte:
 - Afati I mbledhjes se ketyre taksave dhe tarifave vendore do te jete 1 (nje) vit me te drejte perseritje.
 - Ndermarrja e Ujesjelles-Kanalizimeve Sh.A. Roskovec, ne rolin e agjentit tatimor, do te perfitoje 3% te shumes mujore, te arketuar nga taksat dhe tarifat vendore te Bashkise Roskovec.
 - **Bashkia Roskovec:**

1.Ka detyrimin te depozitoje prane Agjentit Tatimor, listen e plote emerore te kryefamiljareve,se bashku me nivelin e taksave dhe tarifave vendore sipas llojit te tyre.


2.Ka detyrimin per te paraqitur ne fund te cdo muaji prane Agjentit Tatimor, ndryshimet qe do te pesojne listat.

- 3.Ka detyrimin te sqaroje qytetaret per cdo paqartesi/shqetesim ne lidhje me tarifate dhe taksat vendore nepermjet Sektorit te Tatim- Taksave.
- 4.Ka te drejte te kerkoje periodikisht nga Agjenti tatimor, informacion per zbatimin e aktmarreveshjes.
- 5. Ka detyrimin qe nepermjet Sektorit te Tatim-Taksave te rakordoje me Agjetin Tatimor , per cdo tatimpagues . nje e nga nje, me vlerat perkatese , cdo date 30 ose 31 te cdo muaji.
- 6.Ka te drejte te kerkoje derdhjen e detyrimit (arketimin) ne llogarine e saj te te ardhurave cdo date 30 ose 31 te cdo muaji, ,ne perqindje , sipas nenit 5 te kesaj aktmarreveshje.
- 7.Ka detyrimin qe nepermjet Sektorit te Tatim-Taksave , te beje azhornimin e listave te taksapaguesve , brenda dates 1 – 2 te cdo muaji.

- **Agjenti Tatimor (Ujesjelles-Kanalizime sh.a Roskovec)**

- 1.Ka detyrimin qe te pranoje listen e plote emerore te kryefamiljareve ,se bashku me nivelin e taksave dhe tarifave vendore sipas llojit te tyre ,qe do te depozitohen nga Bashkia Roskovec;
- 2.Ka detyrimin qe te bej perditesimin e te dhenave nga database sipas ndryshimeve te derguara ne forme shkresore nga Bashkia Roskovec;
- 3.Ka detyrimin qe te shenoje si ze me vete ,ne faturen mujore te ujit te pijshem,detyrimin e qytetareve ndaj Bashkise Roskovec (I ndare ne keste mujore te barabarta),pa e llogaritur TVSH;
- 4.Ka detyrimin qe nga data **1 – 10** te cdo muaji te prodhoje faturat per cdo taksapagues te listuar nga Bashkia Roskovec.
- 5.Ka detyrimin qe nga data **11-20** te cdo muaji te shperndaje faturat ne cdo banese.
- 6.Ka detyrimin, te vjele detyrimin financiar nga data **20 – 30** te cdo muaji.
- 7.Ka detyrimin qe brenda dates **30-31** te cdo muaji te beje rakordimin me Sektorin e Tatim-Taksave te Bashkise Roskovec, per cdo taksapagues , nje per nje, me vlerat perkatese si dhe te arketoje shumen perkatese per llogari te Bashkise Roskovec.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, Tel/Fax : 0382 22117

VENDIM

NR 5 .DATE 19.01.2018

"PER

KRIJIMIN E INSPEKTORIATIT VENDOR TE BASHKISE ROSKOVEC"

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.139/2015 "Per veteqevrisjen vendore" ; neni 54 germat k dhe n, si dhe te ligjit nr.10 433, date 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" neni 14 i tij Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

1. Miratimin per Krijimin e Inspektoriatit Vendor me perberje si me poshte:

- | | |
|---|----------------|
| 1. Kryeinspektor - | Elis Hatia |
| 2. Inspektor biznesi+trasnporti publik- | Mirel Prifti |
| 3. Inspektor mjedisi - | Habibe Hajdini |
| 4. Inspektor pyjesh - | Agron Dardha |
| 5. Inspektor bujqesie, ushqimi, peshkimi- | Fitim Agaci |
| 6. Inspektor urbanistike- | Eldison Kocaqi |
| 7. Inspektor higjene- | Manjola Vrap |

KRYETAR

Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa : Qendër Roskovec, www.bashkiaroskovec.gov.al

VENDIM

Nr. 6 datë 19/01/2018

**PËR KRIJIMIN E “GRUPEVE LOKALE TË VEPRIMIT” (GLV)
/ “LOCAL ACTION GROUPS” (LAG)
PËR FERMERËT TË CILËT OPEROJNË NË BASHKINË ROSKOVEC**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Programit të Zhvillimit Rural 2014-2020 të Republikës së Shqipërisë, Programit IPARD II (Instrument for Pre-accession Assistance Rural Development), si dhe kuadrit ligjor mbi të cilin mbështeten marrëdhëniet midis OJF-ve dhe qeverisjes vendore, konkretisht: Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr 8788, datë 07.05.2001 “ Për organizatat jofitimprurëse”, Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”, Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, Ligjit nr 7892, datë 21.12.1994, “ Për sponsorizimet”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Krijimin e partneritetit trepalësh: shoqëri civile- qeverisje vendore- komuniteti i biznesit (fermerë), për Grupet Lokale të Veprimit (GLV) / Local Action Groups (LAG) në Bashkinë Roskovec.

Në kuadër të thirrjeve të lançuara prej Bashkimit European për alokimin e fondeve për sektorin e bujqësisë, si dhe duke u bazuar në Programin e Zhvillimit Rural 2014-2020 dhe Programit IPARD II (Instrument for Pre-accession Assistance Rural Development), del e nevojshme krijimi i një Grupi Lokal të Veprimit (GLV)/Local Action Group (LAG) me fokus qendër fermerët të cilët operojnë në bashkinë Roskovec.

LAG është një bashkëpunim trepalësh midis Shoqërisë Civile, Qeverisjes Vendore dhe Komunitetit të biznesit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale si për familjet e fermerëve, ashtu edhe për popullatën rurale në tërësi.

Konkretisht, aktorët e Grupit Lokal të Veprimit-LAG, në Bashkinë Roskovec të jenë:
Organizata vendore e shoqërisë civile "Gruaja, komuniteti, mjedisi i harmonizuar për zhvillim",
përfaqësues nga Qeverisja Vendore dhe fermerët.


**2.Përdorimin e një fondi prej 300 000(treqind mijë) lekësh prej fondeve të buxhetit të
Bashkisë Roskovec, për të ngritur strukturën e sipërpërmendur.**

Bashkia Roskovec, si institucion i qeverisjes vendore, duhet të sigurojë instrumentat fillestare për
të nisur këtë iniciativë, nëpërmjet financimit nga fondet e veta.

LAG për fermerët do të funksionojë si një kooperativë sociale, ku një grup fermerësh me interesa
të përbashkëta do të operojnë si një shoqëri e vetme me anë të një NIPT-i të përbashkët.
Sigurimi i një NIPT-ti të përbashkët për krijimin e Ndërmarrjeve Bujqësore Sociale është një
prej synimeve aktuale, pasi ky investim do të rris numrin e të punësuarëve, si dhe do të sjell më
tepër të ardhura në komunitet.

K R Y E T A R

Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 7 datë 19/10/2018

“Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis Zyrës së Këshillit të Europës Tiranë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Roskovec, për projektin ROMACTED : Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të komunitetit rom në nivel vendor”

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ” dhe në bazë të akt-marrëveshjes e cila do të firmoset gjatë muajit Shkurt 2018, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- **MIRATIMIN E PROGRAMIT ROMACTED: “PROMOVIMI I QEVERISJES SË MIRË DHE FUQIZIMIT TË KOMUNITETIT ROM NË NIVEL VENDOR”**

Bashkia Roskovec ka aplikuar dhe është përzgjedhur si fituese për programin “ROMACTED: Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit të Komunitetit Rom në Nivel Vendor” i cili zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Bashkimi European dhe Këshilli i Evropës.

Qëllimi i këtij projekti është :

- (I) fuqizimi i komunitetit Rom në nivel individual (mbështetja e njerëzve për të zbatuar të drejtat e tyre bazë dhe të zhvillojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre), si edhe në nivel komunitar (mbështetja e njerëzve për vet-organizim për të përfaqësuar interesat e tyre rreth zgjidhjes së problemeve komunitare);
- (II) përmirësimi dhe shtrirja e angazhimit, njohurive dhe aftësive të institucioneve në punën për përfshirjen Rome, përmes zbatimit të koncepteve të qeverisjes së mirë;

- **MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TE MIREKUPTIMIT MIDIS ZYRES SE KESHILLIT TE EUROPES TIRANE, MINISTRISE SE SHENDETESISHE DHE MBROJTJES SOCIALE DHE BASHKISE ROSKOVEC**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) është hartuar midis Këshillit të Europës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Roskovec në kuadër të zbatimit të Programit ROMACTED, një nismë e përbashkët midis Bashkimit European (DG NEAR) dhe Këshillit të Europës, zbatuar në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MM) është të sigurojë një kuadër të bashkëpunimit midis palëve të mësipërme në kuadër të zbatimit të Programit ROMACTED, që synon të promovojë qeverisjen e mirë dhe fuqizimin rom në nivel vendor.

KRYETAR

Eleni Goga

